

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i shkencave shoqërore dhe albanologjike, organizuan - *Dita e albanologjisë në Kinë - Përurime botimesh dhe projektesh* (Me pjesëmarrjen e albanologeve prof. dr. Chen Fenghua dhe prof. dr. Ke Jing), në sallën “A. Buda” të Akademisë së Shkencave, më 31 tetor 2018.

Pranë Universitetit të Studimeve Ndërkombëtare të Pekinit (BFSU), i njohur shkurt me emrin “Bei-Wai”, që do të thotë “Pekin-1”, funksionon e vetmja katedër albanologjie në gjithë kontinentin aziatik.

E themeluar në vitin 1961, kjo katedër është në të njëjtën kohë njësi shkencore universitare, qendër kërkimore shkencore dhe bord përkthimesh e botimesh.

Shkolla doktrale e BFSU u kushtohet çështjeve të rendit parësor në albanologji e në lidhjet kino-shqiptare, si: identiteti shqiptar përmes veprës së Kadaresë dhe opozicionit “vetja dhe tjetri”; ndikimi i filmit shqiptar në kinemanë kineze, shteti dhe feja në Shqipëri, Kadare dhe Andrić në vështrim krahasues, Migjeni dhe Lu Sin si poetë socialë, imazhi i Kinës në letërsinë shqipe, restaurimi e shërimi i kodikëve të Shqipërisë në Kinë etj.

Vitin e kaluar pranë kësaj katedre u themelua “Center Studies for Albania”, që organizon çdo vit veprimtari kërkimore e shkencore.

Të gjithë pedagogët e kësaj katedre janë jo vetëm hartues tekstesh universitarë, por dhe autorë monografish e përkthyes të letërsisë shqipe në gjuhën kineze. Janë përkthyer disa romane si: “Aksidenti”, nga Mimoza, siç njihet me emrin e saj shqiptar, përgjegjësja e katedrës, një koleksion dokumentesh arkivore për lidhjet shqiptaro-kineze në vitet 1960, po përkthehen nga Shqiponja, Gjina, po përkthen romanin “Arka e djallit”, të D. Agollit.

Më 31 tetor 2018, në ditën e albanologjisë në Kinë, që u zhvillua në Akademinë e Shkencave u përuruan tre botime: “Fjalori dygjuhësh shqip-kinezisht e kinezisht shqip”, me mbi 40 mijë fjalë, hartuar nën drejtimin shkencor të albanologes dhe ballkanologes Ke Jing (Gjina); “Enciklopedi e shkurtër e historisë dhe e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë” përgatitur po nga prof. Ke Jing, me bashkëpunimin e dr. Ma Sai; si dhe romani “Aksidenti”, përkthim i prof. Fenghua Chen (Mimoza). Gjithashtu u paraqitën disa tekste universitare, si “Gramatika praktike e shqipes” në dy vëllime (prof. Ke Jing); “Shqipja e folur” në dy vëllime (prof. Fenghua Chen).

Shtëpia botuese universitare, në bashkëpunim me katedrën e shqipes, do të përkthejë 25 tituj nga letërsia shqipe, prej De Radës deri tek autorët e sotëm.

Katedra ka fituar projektin e hartimit të një fjalori të madh të shqipes. Bashkëpunëtorë të saj, si prof. Zheng Enbo, kanë përgatitur e botuar një antologji dyvëllimëshe të poezisë shqipe, me 70 autorë.

Me kujdesin e katedrës dhe punën e saj, rreth 60 personalitete shqiptare do të jenë zëra më vete në Enciklopedinë e Kulturës Kineze.

BFSU, përveçse me Akademinë e Shkencave, ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, të Vlorës e të Gjirokastrës.

Profesorë shqiptarë mbajnë kurse të plota leksionesh në BFSU, kurse prof. Ke Jing ka mbajtur ligjërata shqip në Tiranë, Vlorë, Shkodër, Tetovë e Prishtinë.

Katedra e gjuhës shqipe në BFSU përgatit studiues, përkthyes, diplomatë dhe specialistë të tjerë. Ajo është kryeqendra e albanofonëve të Kinës dhe një përruese shumë dashamirëse e identitetit shqiptar në Kinë e në botë.

Akad. Floresha Dado, kryetare e Seksionit të shkencave shoqërore dhe albanologjike, në fjalën e hapjes së këtij aktiviteti e cilësoi këtë takim të një rëndësie të veçantë dhe specifik, pasi për herë të parë Seksioni i shkencave albanologjike të Akademisë së Shkencave organizon promovimin e produkteve shkencore të një prej qendrave albanologjike më të rëndësishme që veprojnë në botë, siç është departamenti i gjuhës shqipe në Pekin, e jo thjesht promovim të botimeve të rëndësishme, por njëkohësisht mirënjohje, vlerësim dhe projekt për bashkëpunime të mëtejshme, ku ndihma dhe kontributet e studiuesve shqiptarë do të jenë më të ngushta dhe më të dendura. Një vizion dhe projekt mësimor, dhe shkencor kaq i qartë në synimet e kësaj qendre albanologjike, theksoi prof. Dado, e ka bërë këtë Departament qendrën kryesore të albanofonëve të Kinës. Dhe arritja e fundit është që, me iniciativën dhe përpjekjet e prof. Ke Jing, ky Departament arriti të realizojë specifikën e veçantë *Shqip plus*, që do të thotë se studiuesit e gjuhëve dhe kulturave të tjera ballkanike gradualisht do të kenë gjuhën shqipe si pikënisje kryesore, duke i dhënë shqipes një pozicion të ri, më të vlerësuar. Është meritë e pasionit, e mënçurisë, e profesionalizmit dhe dashurisë për shqipen e prof. Ke Jing, e cila me energjitë e jashtëzakonshme të saj, ka bërë që dega e albanistikës në Pekin të fuqizohet dallueshëm në raport me katedrat e tjera të Evropës dhe Ballkanit. Veprat madhore që po promovohen sot janë dëshmi serioze e fizionomisë së kësaj katedre, ku roli orientues i prof. Ke Jing, në bashkëpunim të ngushtë me përgjegjësen e katedrës Prof. Chen Fengua dhe ekipin e pedagogëve e lektorëve, si dhe bashkëpunëtorët e përhershëm të saj, është i jashtëzakonshëm. Është vizioni i qartë i prof. Ke Jing që BFSU ka ndërtuar marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave, me Universitetin e Tiranës, me Universitetin e Vlorës të Gjirokastrës. Përtej kësaj është synuar që aktiviteti i kësaj qendre mësimore e shkencore të marrë një karakter panshqiptar, duke vendosur marrëdhënie me universitete në Kosovë dhe Maqedoni. Me një ekip pedagogesh shumë seriozë profesoreshat që kemi këtu sot, na venë para thellimit të përgjegjësisë sonë të përbashkët: si Akademi e Shkencave dhe universitetet shqiptare. Seksioni i shkencave shoqërore dhe albanologjike ka një bashkëpunim shumë serioz, (në mbajtje ligjëratash për kurse të plota në nivelin bachelor dhe doktorat, në udhëheqje shkencore të studentëve, në konsultime për aspekte më madhore shkencore). Ky bashkëpunim do thellohet në realizimin e disa projekteve të ardhshme. Seksioni ynë do të ketë si një nga prioritetet e ardhshme promovimin e aktiviteteve mësimore e shkencore të gjithë qendrave albanologjike, kudo ku ato janë. Ky është një detyrim kombëtar, shkencor dhe moral, përfundoi fjalën e saj akad. Floresha Dado.

Fjalën përshëndetëse, në emër të Akademisë së Shkencave e mbajti sekretari shkencor **akad. Vasil S. Tole**: - Një ditë kushtuar albanologjisë që zhvillohet në Kinë, në Pekin, në Universitetin e Studimeve Ndërkombëtare të Pekinit, për ne që e dimë se sa e shumanshme dhe e suksesshme është kjo veprimtari, nuk mjafton. Por edhe me kaq pak kohë sa jemi së bashku këtu u bënë të ditura shumë punë. Para së gjithash doja t'ju informoja se ne kemi pritur në institucionin tonë me një kënaqësi të veçantë një delegacion të Universitetit Pekin-1, ose Bei-Wai-t, siç njihet universiteti që përmenda, të kryesuar nga Presidenti, prof. Peng Long, dhe kemi miratuar parimisht një marrëveshje bashkëpunimi, që do të marrë formë zyrtare sapo që Akademia jonë të ketë një rregullim të ri ligjor dhe një Kryesi të re. Ne kemi bashkëpunuar me Universitetin BFSU edhe pa marrëveshje, duke shkëmbyer ekspertë e ekspertiza, duke lehtësuar bashkëpunimin ndërakademik e ndëruniversitar, duke pasuruar njëri-tjetrin me botime e studime, duke mirëpritur në revistat tona artikuj e studime dhe në

shumë forma të tjera. Katedra e gjuhës shqipe në BFSU është themeluar në vitin 1961. Ajo nuk është thjesht një katedër, por një shkollë albanologjie, me tre cikle studimesh universitare e pasuniversitare, formuese e kërkuesve në gjuhën, historinë dhe identitetin shqiptar; e gazetarëve, përkthyesve dhe diplomatëve, mbi të gjitha e albanologëve dhe ballkanologëve. Modeli i këtij formati albanologësh është prof. Gjina, e cila mund të quhet themeluese e një tradite të re, që do të shprehej me fjalët: *të hysh në ballkanistikë përmes shqipes*. Në këtë e çmojmë si një gjetje shkencore e cila na përshfaq edhe virtytet qëllim mira të miqësisë. Këtu do të njihemi me shumë nisma të katedrës së albanologjisë në BFSU, por dëshiroj të veçoj një fakt tjetër. Pranë kësaj katedre funksionon *Center Studies for Albania*, që e drejton prof. Mimoza; ndërkohë që *Center Studies for Balkan* drejtohet nga prof. Gjina. Dhe bashkëpunimi i këtyre dy qendrave kërkimore, që organizojnë konferenca e botime, platforma debati e dialogu, mbështetet mbi një filozofi shumë dashamirëse dhe frutdhënëse për ne. Akademia e Shkencave ndien si detyrë të vetën të mbështesë zhvillimin e albanologjisë në BFSU në format ekzistuese e në forma të reja. Akademikët shqiptarë do të asistojnë kolegët tanë kinezë me çdo mundësi për hartimin e fjalorit të madh shqip-kinezisht. Akademia nuk do të kursehet për dërgimin e ligjëruesve të lëndëve të veçanta nga ana e saj, për supervizione shkencore dhe ndihma të tjera. Vitin e ardhshëm është 70-vjetori i Kinës së Re, 70-vjetori i pavarësisë së Kinës. Prandaj ne do të synojmë që vitin e ardhshëm të organizojmë së bashku një konferencë shkencore jubilarë. Dhe me këtë rast të zgjerojmë bashkëpunimin edhe me arkivat, ku gjendet një histori e përbashkët, që nuk duhet ta lëmë të na bëhet e largët. Vendi ynë Shqipëria, me rezolutën e saj të vitit 1971, ka luajtur një rol vendimtar, vetë dhe me lobingun e saj diplomatik, për rikthimin e anëtarësisë së RP të Kinës në OKB. Me këtë rast ai i dhuroi zonjës Ambasadore një kopje të darft rezolutës së atij viti, që Shqipëria dhe disa shtete anëtare të OKB ndërmorën me vullnet të plotë për rikthimin e të drejtave të Republikës Popullore të Kinës si vend anëtar i OKB-së. Me urimin që koleget albanologë nga Pekini të kenë gjithnjë suksese dhe të na vijnë më shpesh dhe me konfirmimin e vullnetit tonë të vendosur për bashkëpunim edhe më intensiv, e mbylli fjalën e tij akad. Vasil S.Tole.

Në këtë aktivitet mori pjesë edhe ambasadorja e RP të Kinës në Shqipëri, **znj. Jiang Yu**, e cila në fjalën e sajë përshëndetëse vlerësoi bashkëpunimin e dy shteteve dhe në veçanti bashkëpunimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me Beijing Foreign University (Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit) për këtë pasurim e shkëmbim botimesh, studimesh shkencore e kulturore të ndërsjella të dy shteteve tona.

Për rëndësinë e Fjalorit shqip-kinezisht dhe kinezisht-shqip (me mbi 40 mijë fjalë), botim i Departamentit të Gjuhës Shqipe të BFSU, nën drejtimin e prof. dr. Ke Jing, referuan **prof. Emil Lafe** dhe **akad. asoc. Gjovalin Shkurtaç**.

Prof. Emil Lafe, duke i cilësuar *Fjalorin shqip-kinezisht dhe kinezisht-shqip* dhe *Gramatikën praktike të gjuhës shqipe* si dy vepra të rëndësishme të albanologjisë kineze, e nis referimin e tij me citimin: *Gjuha shqipe, letërsia shqiptare, kultura shqiptare në përgjithësi kanë një shtëpi të bukur në Kinë, e cila ndodhet në Universitetin e Gjuhëve të huaja në Pekin, që është një kopsht i lulëzuar dhe shumë tërheqës i arsimit universitar atje, departamenti i gjuhës dhe i letërsisë shqipe*.

Albanologjia kineze është mjaft e re në krahasim me vende të tjera ku ka pasur prej kohësh interesim për Ballkanin në përgjithësi dhe për Shqipërinë në veçanti, por ky departament, ndryshe nga qendra të tjera albanologjike është dinamik, gjë që na jep kënaqësi,

krenari, por edhe përgjegjësi. Punët e kolegeve tona kineze janë bërë të njohura nëpërmjet një vargu artikujsh të botuar në gjuhën shqipe, në revista e përmbledhje shkencore në Shqipëri, në Kosovë e Maqedoni, përveç shkrimeve në shtypin e shkruar e në televizion. Fjalori shqip-kinezisht dhe kinezisht-shqip (me mbi 40 mijë fjalë), me 1189 faqe, nuk është i pari fjalor, por pa dyshim më i ploti dhe më i përpikti, që po të përdoret një term më teknik do të thuhet më *i kolauduari*. Ky fjalor është një arritje e shënuar në radhë të parë për albanologjinë kineze, por edhe për albanologjinë në përgjithësi. Ai synon të plotësojë nevojat e studentëve që mësojnë gjuhën shqipe në Kinë e ata që mësojnë gjuhën kineze në Institutin “Konfuci” në Tiranë, jo vetëm gjatë orëve të mësimin, por edhe t’i ndihmojë ata kur të dalin në punën e tyre të pavarur. Një fjalor i përgjithshëm është gjithësesi i pamjaftueshëm për marrëdhëniet e sotme të dendura ndërmjet dy vendeve tona, dhe mendoj, shprehet prof. E. Lafe, se pas këtij e kanë radhën të hartohen edhe fjalorë terminologjikë për fusha të ndryshme të shkencës, teknikës, artit etj.

Pas një përvoje të gjatë mësimore, pedagogët e këtij departamenti kanë nxjerrë, me jo pak vështirësi, edhe veprën tjetër shumë të rëndësishme *Gramatikë praktike të gjuhës shqipe*, të hartuar në gjuhën kineze, që, edhe kjo mund të quhet *e kolauduar*, por që mund të përmirësohet aty-këtu, duke mos harruar se vepra të tilla kanë një mundim të madh në formulimin e fjalive me të cilat duhet të shpjegohet e të sqarohet rregulla përkatëse. Prof. Emil Lafe nuk la pa përmendur edhe pedagogun e parë kinez të gjuhës shqipe, mikun e kolegun e tij In Çan Ljan, i cili hapi më 1961 në Kinë, atë që ai e quajti *shtëpia e bukur e gjuhës shqipe dhe e kulturës shqiptare*.

Në fund të referimit, prof. Emil Lafe kujtoi dy festat jubilarë të vitit të ardhshëm: 70-vjetorin e RP të Kinës dhe 75-vjetorin e çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi nazi-fashist, e ftoi Akademinë e Shkencave dhe BFSU-në që këto data të rëndësishme t’i kenë parasysh në programin e tyre të bashkëpunimit.

Akad.asoc. Gjovalin Shkurtaj në fjalën e tij përgëzuese dhe përuruese mbi *Fjalorin kinezisht-shqip e kinezisht-shqip*, në kuadrin e botimeve dhe veprimtarisë mësimore e shkencore të katedrës së shqipes në Kinë, shpreh në radhë të parë ndjenjën e gëzimit dhe nderimit si gjuhëtar ashtu si dhe kolegët e tjerë, po edhe thjesht si shqiptar. Një popull i madh, me tradita e kulturë të lashtë i bën vend gjuhës shqipe në radhën e gjuhëve që meritojnë të njihen e të mësohen, duke pasur edhe mëtimin frymëgjatë e shumë të lakmueshëm për ne: të jetë gjuha jonë edhe si një “derë” nëpërmjet së cilës në Kinë të mund të njihen edhe letërsia e botimet me interes nga vende të tjera. Këto përpjekje të dobishme jo vetëm kanë ngritur nivelin e kërkimit të tyre, por edhe kanë bërë që më shumë studiues kinezë dhe shqiptarë të përqendrohen në çështjen shqiptare dhe në punën kërkimore në Kinë.

Prof. Shkurtaj theksoi në veçanti disa pika ku shfaqet rëndësia e këtij Fjalori: së pari, sepse gjeografia e albanologjisë dhe e njohjes së gjuhës shqipe me anë të veprave leksikografike dygjuhëshe shkon deri në Kinën e madhe e të largët, po edhe pse, duke qenë se ai doli në një kohë kur edhe zhvillimi e standardizimi i shqipes kanë mbërritur në lartësi më të mëdha se dikur, nëpërmjet këtij Fjalori, si të thuash, bëhet një “patentim” i shqipes së shkruar në plan ndërkombëtar, si gjuhë e një populli e kombi të vogël, por që interesimin, vlerësimin dhe kujdesin për hiret e fjalët e saj i ka shumë të mëdha.

Së dyti, ai thekson se, botimi i këtij Fjalori është një prurje e rëndësishme për leksikografinë dygjuhëshe shqip-gjuhë e huaj.

Para Fjalorit që po përrurojmë sot, kemi pasur disa fjalorë dygjuhësh të shqipes me një nga gjuhët e huaja si: shqip-gjermanisht e gjermanisht-shqip, shqip-italisht, shqip-anglisht, shqip-frengjisht, shqip-serbokroatisht, shqip-greqisht e të tjerë, kurse vargu i fjalorëve shqip-gjuhë e huaj, së paku deri sot, mbyllet me *Fjalorin-shqip-kinezisht*, të vitit 2018, që vlen për të përgëzuar ideatorët, hartuesit dhe krejt ekipin realizues të tij.

Në mbyllje të kësaj kumtese prof. Gj. Shkurtaj propozon se, ndoshta ka ardhur koha që në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës të çelej edhe një katedër e gjuhës dhe e letërsisë e kulturës kineze, duke qenë se Kina është një vend në zhvillim të pandalshëm dhe me një pozitë tashmë gjithnjë e më të fuqishme ekonomike e politike në arenën ndërkombëtare, e njohja e gjuhës kineze do të përbënte një avantazh të padiskutueshëm konkurrues për shqiptarë dhe të rinj nga vendet e Ballkanit, duke plotësuar kështu edhe kuadrin e një ndërsjellësie të frytshme me katedrën e gjuhës shqipe në Universitetin e Pekinit.

Akad. asoc. Shaban Sinani *Enciklopedinë e shkurtër të historisë dhe të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë*, e cilësoi si një prej dëshmimeve të karakterit shumanësh të punës së katedrës së shqipes në BFSU. Ajo është përgatitur nën drejtimin shkencor të prof. Ke Jing, me bashkëpunimin e pegadoges së re Ma Sai (Bora).

Çfarë është kjo enciklopedi? Unë nuk e njoh gjuhën kineze, thotë prof. Sinani, por mund t'u bëj të njohur të pranishmëve një panoramë të përmbajtjes së saj duke iu referuar tekstit shqip dhe anglisht mbi të cilin është mbështetur botimi dhe sidomos një dialogu shumë intensiv që kemi pasur me dy autorët e botimit gjatë kohës së përgatitjes së tij.

Kjo është një enciklopedi e formatit european, jo vetëm për faktin se botimi i parë i saj, që ka shërbyer si bazë edhe për botimin në gjuhën kineze, është mbështetur nga Bashkimi European dhe UNDP, por mbi të gjitha për mënyrën si janë përzgjedhur kryevlerat e trashëgimisë materiale e jomateriale shqiptare për t'i përruruar në mjedisin kinez.

Një kapitull u është kushtuar pasurive arkeologjike shqiptare, shtresave të kryehershme të saj, me një vëmendje të posaçme për sitin arkeologjik të Butrintit, pasuri e UNESCO-s.

Rregullimi urban i jetës qytetare në Shqipëri, arkitektura popullore dhe ajo makrometrike zënë një kapitull tjetër, dhe në këtë rast Gjirokastra e Berati zënë kryet e vendit, duke qenë gjithashtu dy qytete që janë nën mbrojtjen intelektuale të UNESCO-s.

Sa i takon historisë së popullit shqiptar, etnogjenezës, lashtësisë, burimit, vazhdimësisë, këto çështje janë renditur në një kapitull tjetër, në të cilin shumë rëndësi ka sidomos periodizimi i historisë së periudhës shtetërore, duke iu referuar alternativave të herëpashershme të sistemit shoqëror nga principata e trashëgueshme tek këshilli i shtetit apo regjenca, forma të kurorës polikratike, nga republika në monarki etj.

Origjina e shqipes dhe historia e zhvillimit të saj si gjuhë e shkruar, pa lidhje gjenetike me degë e nëndegë gjuhësh të tjera të së njëjtës familje; lindja, zhvillimi, periudhat dhe personalitetet më të rëndësishëm të letërsisë shqipe prej Gjon Buzukut deri tek brezi i shkrimtarëve dhe poetëve post-Kadare; paraqiten me gjuhë të thjeshtë por duke iu përmbajtur tezave të vërtetueshme shkencore.

Në mënyrë më të përqendruar në këtë enciklopedi janë paraqitur disa trashëgimi që zakonisht njihen si albanizma. Kapituj më vete përbëjnë etnosi dhe eposi shqiptar, me veçantitë e veta krahasuar me poemat dhe mitologjinë homerike dhe me epet europiane e ballkanike të Mesjetës; pastaj koleksioni i kodikëve, një prej më të pasurve në botë, dy prej të cilëve të restauruar dhe shëruar në Kinë, tashmë të regjistruar në programin e vlerave më

elitare që promovohen në UNESCO, *Memoire du Monde*; në vijim edhe koleksioni i statuteve, si dëshmi të zhvillimit sinkronik të vendit me gjithë kontinentin në shekujt e humanizmit europian; kanunet dhe korpuse të tjera të së drejtës tradicionale shqiptare, rregullatorë të jetës së popullit në kushtet e sundimit të një perandorie që kishte karakter ushtarak e teokratik; pasuritë e rralla arkivore të Shqipërisë; dëshmitë e marrjes në mbrojtje dhe të shpëtimit të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore etj.

Këtyre kapitujve u bashkohen edhe pjesët kushtuar disa cilësive etnotipike të shqiptarëve, si bashkëjetesa paqësore ndërkulturore, ndëretnike dhe ndërftare, solidariteti, figurat me të cilat shqiptarët identifikohen, si Nënë Tereza e Gjergj Kastrioti.

Një zgjedhje e mençur ka qenë leximi i traditës kulturore shqiptare përmes disa trashëgimive me informacion thellësisht të kodifikuar, si heraldika dhe emblematika, numizmatika dhe filatelia.

Natyrisht që pamjen e vetë më të bukur të denjë për përrurim në mjedise ndërkombëtare Shqipëria e ka në arte dhe letërsi, sidomos në artet figurative, në pikturën e të huajve më së pari, ku, ndonëse sundon romantizmi e ekzotika, bota shqiptare shpërfaqet me denjësi.

Nuk mungojnë vrojtimitet demografike, demokulturore e demoetnike, që pasurojnë pamjen e përgjithshme të vendit, ashtu sikurse dhe historia e institucioneve më të rëndësishme kulturore, arsimore dhe shkencore, duke përfshirë Universitetin e Tiranës, Akademinë e Shkencave, Radiotelevizionin Shqiptar etj.

Në fund të këtij aktiviteti folën **prof. dr. Chen Fenghua**, përgjegjëse e Departamentit të Gjuhës Shqipe në BFSU: *Përkthimi i letërsisë shqipe në gjuhën kineze* (projekti i një biblioteke të vogël prej 25 titujsh në gjuhën kineze, dhe përvojën vetjake të saj në përkthimin e romanit “Aksidenti” të I. Kadaresë) dhe **prof. dr. Ke Jing** - *Albanologjia sot në Kinë*: shkolla e doktoraturës dhe tematika e zgjedhur, projekti për një fjalor të madh dygjuhësh: shqip-kinezisht dhe kinezisht-shqip, si dhe për marrëveshjet dhe bashkëpunimin ndëruniversitar në perspektivë.

Në vitin 2015, thotë **prof. dr. Chen Fenghua**, me ndihmën e Ambasadës së Kinës në Shqipëri, është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe Kinë-Shqipëri, *për përkthimin dhe botimin e ndërsjellë të veprave klasike*, për të thelluar shkëmbimet kulturore, historike, veprat dhe shkrimtarët më të shquar si dhe miqësinë tradicionale midis dy vendeve tona. Kjo marrëveshje, caktoi që të dyja palët të botojnë nga 25 vepra të shquara brenda 5 vjetëve. Qoftë në përmasa, qoftë nga rëndësia, kjo marrëveshje mund të konsiderohet si më e madhja në historinë e shkëmbimeve kulturore mes Kinës dhe Shqipërisë.

Në Kinë, BFSU-ja (Beijing Foreign Studies University) dhe shtëpia botuese FLTRP (Foreign Language Teaching and Research Press), me përparësinë e vet në fushën e studimeve albanologjike, janë ngarkuar me këtë projekt, kanë krijuar komisionin e ekspertëve kinezë dhe shqiptarë, dhe kanë propozuar listën e librave që do të përkthehen. Në Shqipëri, me organizmin e Shoqatës së Botuesve të Shqipërisë dhe me ndihmën e Shoqatës Kulturore Shqipëri-Kinë, janë përfshirë disa botues cilësorë, si dhe një grup përkthyesish veteranë, si Iljaz Spahiu, Kujtim Ymeri etj. Pas përpjekjeve dyvjeçare, nga të dyja palët janë botuar tetë vepra, si *Nënë Shqipëri*, *Enciklopedi e shkurtër e historisë dhe trashëgimisë kulturore të Shqipërisë*, *Hyrja në historinë dhe kulturën kineze*, *Rruga kineze e reformave dhe zhvillimit ekonomik*, etj. Botuesit kinezë dhe shqiptarë kanë organizuar promovimet e këtyre veprave, ose në një rast të caktuar, si me rastin e panairit të librave ndërkombëtarë, për të reklamuar

këto vepra të përkthyer. Duhet të theksojmë se veprat jo vetëm po dalin me një ritëm të shpejtë, por edhe se cilësia e tyre garantohet.

Pjesa e dytë e referimit të saj është përvoja vetiake e përkthimit të romanit “Aksidenti”, të I. Kadaresë. Leximi i një vepre letrare mbetet një pushim i këndshëm, thotë prof. Fenghua, kurse përkthimi i saj është krejt ndryshe, një punë shumë e lodhshme e me përgjegjësi.

Së pari, duhet të isha në çdo moment një lexues i kujdesshëm. Në çdo pikë, në çdo qoshe më duhej të ndalesha “për të biseduar me autorin”, për t’i bërë pyetje, çfarë qëndronte nëpër gërmat, paragrafët..., derisa të kapja diçka që të më bindte. Gjatë përkthimit njëvjeçar, nga fillimi deri në fund, në çdo minutë unë ndihesha sikur ecja nëpër akull. Duket se “Aksidenti” luajti rolin e një trajneri me përvojë e më mësoi të bëhem një përkthyes e kualifikuar, duke marrë parasysh diferencat kulturore, kaq të mëdha midis dy gjuhëve. Duke u bërë pjesë e këtij projekti përkthimesh e botimesh, ne do të hapim më shumë dritare për njëri-tjetrin dhe me përpjekjet e çdo përkthyesi dhe botuesi jetët tona do të bëhen më të afërta, kulturat më të kuptueshme dhe lidhjet më të ngushta, përfundoi referimin e saj prof. Chen Fenghua.

Në fund e mori fjalën **prof. dr. Ke Jing**, e cila në referimin e saj i bëri një paraqitje të hollësishme punës së BFSU-së e sidomos Departamentit të Gjuhës Shqipe në Pekin.

Prej vitit 1961, të hapjes së këtij departamenti e deri në vitin 2000, thotë prof. Jing, numërohen 87 studentë të diplomuar e vit pas vit numri i studentëve të regjistruar ka ardhur duke u shtuar, e jo vetëm në studimet *bachelor*, por edhe në ato më të thelluara, në nivel pasuniversitar, master e doktoraturë.

Ajo përmendi edhe shkëmbimet me ligjërata e ndihmesa studimore me akademikë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës profesorë të fushave të ndryshme studimore si: prof. Shaban Sinani, prof. Floresha Dado, prof. Emil Lafe, prof. Rexhep Ismajli, prof. Ruxhdi Stringa, prof. Paskal Milo, z. Iliaz Spahiu etj., si dhe një renditje të detajuar të temave të diplomave ndër vite e temave të doktoraturave të përfundua e në proces, dhe një numër të konsiderueshëm të artikujve të botuar në fushën e gjuhës e letërsisë, kulturës, studimeve rajonale, studime fetare dhe studime për Kadarenë.

Nismat *Një brez një rrugë* dhe *16+1* të Kinës, janë një perspektivë e mirë për shtimin e numrit të studentëve të këtij departamenti si dhe shtimin e shanseve për më shumë punësim për ta, thotë ajo. Gjithashtu, studimet më të thelluara, zhvillimi i konferencave të përbashkëta, botimet e reja, përkthimet dhe botimet e vazhdueshme të artikujve studimorë do të shtojnë bashkëpunimin me Shqipërinë, Ballkanin dhe me institucione të tjera me famë botërore, përfundon referimin e saj prof. dr Ke Jing.